KODI ETIK DHE I SJELLJES SË TRAJNERËVE DHE TË GJITHË PJESËMARRËSËVE

PARATHËNJE

Ky Kod Sjelljeje kërkon angazhimin kolektiv dhe përgjegjësitë individuale të të gjithë atyre që marrin pjesë në sport ndaj standardeve transparente të sjelljes etike dhe një përkushtimi për të siguruar një mjedis të sigurt për të gjithë, në të gjitha aspektet e stërvitjes, garave, dhe aktiviteteve tjera sportive.

Ky kod i sjelljes i referohet Statutit të FGJK dhe kodit të disiplinës së FGJK-së, njashtu është në përputhshmëri me Kodin e Sjelljes së Federatës Ndërkombëtare të Gjimnastikës (FIG).
Të gjithë pjesëmarrësit janë përgjegjës për sjelljen dhe sjelljet e tyre. Çdo pjesëmarrës duhet të kuptojë dhe të respektojë të gjitha rregullat dhe rregulloret e zbatueshme të përcaktuara për sportin e Gjimnastikës.

Federatat e Gjimnastikës e Kosoveës dhe klubet e sajë kanë një përgjegjësi ligjore dhe/ose morale për të adresuar çdo sjellje që mund të dënohet nga ligjet vendore kombëtare dhe ndërkombëtare. Çdo sjellje e paligjshme duhet të raportohet tek autoritetet përkatëse shtetërore. Në këtë rast, FGJK do të ndajë gjetjet përfundimtare dhe sanksionet e vendosura ndaj pjesëmarrësve të gjimnastikës tek autoritetet vendore dhe autoritetet disiplinore të FIG, në përputhje me Kodin Disiplinor të FIG.

Për qëllimet e këtij kodi të sjelljes, pjesëmarrësit do t'i referohen:

- Të gjithë anëtarët e FGJK-së, anëtarët e emëruar, të zgjedhur ose të ri-zgjedhur të qeverisjes, zyrtarët, duke përfshirë gjimnastet/tët (më tutje "atletët"), përfaqësuesit e tjerë të FGJK-së, ose çdo person që konkurron ose merr pjesë në ndonjë nga aktivitetet të Gjimnastikës;

- Të gjithë trajnerët, përfaqësuesit e autorizuar të sportistëve, duke përfshirë stafin teknik, personelin ndihmës mjekësore infermier, prindërit ose çdo person tjetër që punon me, trajton ose ndihmon gjimnastët/tet që marrin pjesë ose përgatiten për ngjarjet e gjimnastikës; dhe,

- Të gjithë gjyqtarët, delegatët dhe zyrtarët e tjerë, punonjësit dhe partnerët e FGJK-së, anëtarët e autoriteteve të gjimnastikës, si dhe çdo person i akredituar ose vullnetar në ngjarjet e Gjimnastikës.

I. PARIMET E PËRGJITHSHME TË INTEGRITETIT DHE RESPEKTIT

- Që të sillen me mirësjellje dhe tw raportojnw çdo vështirësi ose shqetësim në përputhje me procedurat ekzistuese.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+3834414500

- Respektoni të drejtat dhe opinionet e të tjerëve, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor, feja, opinioni politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose sociale, paaftësia mendore ose fizike dhe aftësia sportive ose statusi tjetër.
- Punoni dhe komunikoni në mënyrë bashkëpunuese, duke respektuar rolet, përgjegjësitë dhe detyrat specifike të të gjithë pjesëmarrësve të tjerë dhe rregullat dhe rregulloret që drejtojnë aktivitetin.

- Përmbahuni nga gjuha ose sjellja josportive.

- Përmbahuni rreptësisht nga çdo sjellje që mund të përbëjë, inkurajojë ose nxisë çfarëdo forme ngacmimi, dhune, abuzimi ose në ndonjë mënyrë tjetër të shkaktojë dëm. Kjo përfshin sjellje të pahijshme fizike, seksuale dhe psikologjike.

- Të përmbahen nga çdo gjuhë apo sjellje ngacmuese ose abuzive ndaj të tjerëve personalisht, në mënyrë elektronike ose në çdo platformë të mediave sociale, qoftë në formë private apo publike.

- Të përmbahen nga çdo lloj demonstrimi apo propagande politike, fetare apo racore në çdo garë gjimnastike.

- Trajtoni në mënyrë proaktive gjuhën ose sjelljen abuzive, ngacmuese, manipuluese ose kërcënuese dhe raportoni menjëherë çdo shqetësim për abuzim ose neglizhencë të një pjesëmarrësi tek autoritetet përkatëse.

- Të respektojë parimet më të larta të lojës së ndershme brenda dhe jashtë fushës stërvitore dhe konkurruese dhe pranoni rezultatet e garës me dinjitet.

- Refuzoni çdo ryshfet.

- Abstenoni nga çdo aktivitet bastesh, çdo përpjekje për të manipuluar rezultatet, ose për të marrë pjesë në çdo formë tjetër të aktivitetit të pandershëm, mashtrues ose të paligjshëm.

- Përmbahuni nga çdo abuzim ose keqpërdorim i pozicionit tuaj të besimit, pushtetit ose ndikimit.

- Mbani vlerat e sportit të pastër dhe kurrë mos ndihmoni, përkrahni ose falni përdorimin e drogave të paligjshme ose substancave ose metodave të tjera të ndaluara që përmirësojnë performancën.

- Respektoni ligjet vendase kombëtare, duke përfshirë edhe kur udhëtoni në vende të huaja.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+3834414500

II. PARIMET SPECIFIKE

1. PARIMET SPECIFIKE PËR ATLETËT

- Mbani marrëdhënie respekti me shokët/kolegët e ekipit, trajnerët, zyrtarët dhe stafin e administratës/menaxhmentit.
- Ndiqni një plan trajnimi që është në përputhje me arsimin dhe jetën private dhe i hartuar në konsultim me trajnerët dhe, nëse janë të mitur, me prindërit ose kujdestarët ligjorë, për të arritur qëllimet e dakorduara reciprokisht.
- Ndani me të afërmit e tyre, trajnerët ose zyrtarët ose autoritetet nëse lind ndonjë shqetësim ose raportoni përmes kanaleve të disponueshme, nëse është e përshtatshme.
- Raportoni çdo lëndim apo aksident tek trajneri i tyre, stafi mjekësor dhe paramjekësor dhe prindërit/kujdestari ligjor.
- Pranoni vendimet e zyrtarëve ose gjyqtarëve gjatë ngjarjeve dhe ngrini ankesa të mundshme, dallime mendimesh ose konflikte përmes kanaleve të duhura.
- Siguroni informacione të sakta personale autoriteteve përkatëse.
- Zbatoni të gjitha rregullat dhe procedurat e zbatueshme anti-doping dhe abstenoni nga përdorimi i substancave dhe metodave të ndaluara, barnave që përmirësojnë performancën.

2. PARIMET SPECIFIKE TË TRAJNERIT

- Mbani marrëdhënie profesionale me sportistët, prindërit/kujdestarët ligjorë të sportistëve, stafin teknik dhe mjekësor dhe zyrtarët.
- Sigurohuni që çdo atletë të ndjekë një program trajnimi të planifikuar mire, të përshtatshëm për moshën dhe nivelin e aftësisë së tij, dhe të projektuar për t'i mbështetur ata për të arritur qëllime të dakorduara reciprokisht të pajtueshme me arsimin, fazën e zhvillimit në jetë dhe sport, dhe jetën private të atletit.
- Ruani vigjilencën që procesi stërvitor të vazhdojë të respektojë dhe të marrë parasysh aftësitë specifike fiziologjike dhe karakteristikat psikologjike të çdo atleti, dhe se shëndeti fizik dhe mendor aktual dhe afatgjatë, siguria dhe mirëqenia e çdo atleti të mbetet prioriteti mbi çdo qëllim ose rezultat.
- Qëndroni aktual me njohuritë më të fundit të shkencës sportive.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+3834414500

- Kryeni një vlerësim të vazhdueshëm të sigurisë së mjedisit të trajnimit dhe për të marrë hapa për të korrigjuar menjëherë çdo shqetësim të identifikuar të sigurisë.

- Mos i anuloni kurrë ekspertët mjekësorë dhe të respektoni këshillat mjekësore në lidhje me atletët që vuajnë nga ndonjë sëmundje ose lëndim, gjendje të shëndetit mendor, ose në trajtimin e përshkruar, në një protokoll rikuperimi gjatë kohës së kthimit në stërvitje graduale.

- Përmbahuni nga çdo koment ose sjellje të papërshtatshme, të pandjeshme, lënduese, tallëse ose kritike në lidhje me pamjen fizike, formën trupore ose peshën e atletit.

- Trajtoni të gjithë atletët me barazi, respekt dhe drejtësi dhe shmangni çdo lloj konflikti interesi, të pahijshme ose favorizuese.

- Jepni komente në mënyrë të sinqertë, pozitive dhe siguroni një qasje faktike dhe konstruktive që lejon atletët të shprehin pikëpamjet e tyre pa frikë nga pasojat.

- Dëgjoni në mënyrë aktive shqetësimet e shprehura nga atletët dhe ndiqni veprimet e duhura për të zgjidhur çështjet.

- Sigurohuni që çdo kontakt fizik me një atlet është i përshtatshëm për situatën dhe i nevojshëm për zhvillimin e aftësive dhe/ose sigurinë e atletit.

- Respektoni rregullat e garës dhe mos i kompromentoni kurrë atletët duke mbrojtur masat që bien ndesh me çdo rregull të konkurrencës.

- Raportoni çdo sjellje, ose dyshim për sjelljen për të cilën ai/ajo bëhet i vetëdijshëm që mund të përbëjë ngacmim, dhunë ose abuzim, duke përfshirë çdo sjellje të keqe fizike, seksuale dhe psikologjike ndaj atletëve të rinj.

3. PARIMET E GJYQTARIT DHE ZYRTARE SPECIFIKE

- Drejtësi absolute, paanshmëri dhe qëndrueshmëri në të gjitha situatat e gjykimit.

- Të prezantohen për një funksion të caktuar të përgatitur mirë dhe të kryejnë të gjitha detyrat me profesionalizëm, kompetencë dhe mirësjellje.

- Punoni në frymën e bashkëpunimit dhe respektit me zyrtarë të tjerë dhe organizatorë të ngjarjeve.

- Siguroni të dhëna dhe komente në mënyrë konstruktive dhe pozitive, kur kërkohet, në kohën dhe vendin e duhur.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+3834414500

- Mbani gjithmonë si prioritet të parë mirëqenien dhe integritetin fizik, psikologjik dhe mendor të sportistit.

- Raportoni tek autoritetet përkatëse çdo individ që pranon ryshfet, ose është i përfshirë në manipulimin e rezultateve të konkurrencës, ose ndonjë veprimtari tjetër mashtruese ose të paligjshme.

III. KODI ETIK I TRAJNERËVE

Përveç kodit të përgjithshëm të sjelljes në FGJK, trajnerët duhet që të përmbushin kërkesat në lidhje më sjelljen e tyre gjatë çdo aktiviteti të mbajtur, ose sanksionuar nga FGJK, një klub ose shoqatë ku ju jeni të caktuar në rolin e trajnerit nga FGJK:

1. Përmbahuni rregullave të FGJK-së, siç përcaktohen me akte dhe nene të dalura nga Statuti dhe Rregulloret e FGJK-së:

    - Duhet që të përcjellet procedura për zbatimin e kodit të etikës,

    - Të pranoj çdo gjykim të bërë dhe;

    - Përdoren procedurat e vendosura për të sfiduar një rezultat garues, duke kundërshtuar një vendim për përzgjedhjen e ekipit, duke u ankuar për sjelljen e një anëtari tjetër, ose duke u përpjekur për të ndryshuar politikën e Gjimnastikës në Kosovë.

2. Drejtoni të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet tuaja në lidhje me të gjitha aspektet e gjimnastikës, personave përgjegjës, për përmirsimin e sportit të gjimnastikës në Kosovë.

    - Të jeni kontrsuktiv me kritika dhe komente të drejtëpërdrejta dhe vëzhgime në individ dhe Federatë, shmanguni thashethemeve, aludimit ose komentimeve me qëllim të keq,

    - Respektoni përpjekjet e përfaqësuesve të emëruar dhe të zgjedhur nga FGJK.

3. Përfaqësoni vetën dhe statutin tuaj të trajnerit në mënyrë të ndershme dhe profesionale, pa pasur nevoj të sjellni profesionin e trajnerëve të FGJK në diskreditim.

    - Përdoreni statusin tuaj të akreditуar dhe anëtarësimin tënd në FGJK, në mënyrë të denjë, duke shfaqur aftësit tuaja në mënyrë të ndershme, e jo për të fituar favore të pajustifikueshme.

    - Të jeni profesional dhe të pranoni përgjegjësit për veprimet e juaja,

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+3834414500

- Ofroni mirësjellje profesionale trajnerëve të tjerë, atletëve dhe prindërve të tyre, duke i mbajtur ata të informuar në çështjet relevante për programet e trajnimit.

- Vepro në përputhje me rregullat sportive të organizatës dhe të individëve që i administrojnë këto rregulla – rregullore duke ndikuar pozitivisht që edhe prindërit e atletëve tuaj dhe audienca e cila i përcjell garat e gjimnastikës të jenë kundër sjelljeve të këqija, kundër zhurmës gjatë performancës dhe aq më tepër kundër veprimeve të njohura me termin si Huliganizëm.

- Të jeni model për sportin tuaj dhe atletët tuaj,

- Respektoni të drejtat, dinjitetin dhe vlerën e çdo qenieve njerëzore, në kuadër të sjelljes dhe përfshirjes në gjimnastikë.

4. Demonstroni një standard të kudjesit në përputhje me kompetencat dhe detyrimet tuaja si trajner:

    - Trego interesim për shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e atletëve dhe kolegëve.

    - Bëhu trajner brenda kufijve të kompetëncës suaj si trajner,

    - Ndiqni udhëzimet e sigurisë së FGJK-së në lidhje më detyrën e kujdesit që detyroheni ndaj atletëve,

    - Ofroni programe trajnimi të planifikuar dhe të njëpasnjëshëm në bazë të nevojave zhvillimore të atletëve,

    - Modifikoni programin e trajnimit për atletët e lënduar bazuar në rekomandimet dhe këshillat e mjekut,

    - Siguroni një mjedis të sigurt për pjesëmarrësit në trajnim dhe garë.

5. Promovoni dhe ndihmoni në zhvillimin e profesionit tuaj si trajner:

    - Ndihmoni të tjerët në zhvillim, shkathtësi dhe njohuri të mira në lidhje me gjimnastikën,

    - Promovoni dhe ndihmoni në edukimin e trajnerëve të tjerë,

6. Në rend të parë vendosni mirëqenien e atletëve, marrjen e vendimeve bazuar në interesat më të mira të sportistëve tuaj, sportit dhe karrierës profesionale të atletëve,

    - Pranoni talentin individual dhe potencial të atletëve,

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+3834414500

- Vazhoni me mbajtjen e balancuar të përfshirjes sportive, me atë të arsimit dhe edukimit duke arritur objektiva të karrierës,

7. Tregohuni të vëmendshëm dhe mbështetni përpjekjet, për të eliminuar dhe luftuar përdorimin e drogës dhe dopingut në sport,

   - Respektoni rregullat e vendosura nga FGJK, nga Komiteti Olimpik i Kosovës dhe nga organet Qeveritare të vendit,

   - Respektoni shëndetin dhe dinjitetin e atletëve për të garuar në baza të aftësisë së tyre, brenda rregullave të sportit të gjimnastikës.

8. Inkurajoni, mbështeteni heqjen e çdo forme të abuzimit personal ose diskriminimin e papërshtatshëm.

   - Ti shmangeni çdo abuzimi/akuzimi verbal, fizik ose emocional,

   - Të shmangeni nga çdo formë e ngacmimit seksual ndaj gjimnasteve dhe anëtarëve tjerë,

   - Të shmangeni nga përdorimi i ndikimit si trajner, për të krijuar intimitet të papërshtatshëm ndërmjet trajnerit dhe atletit,

   - Të shmangeni nga çdo praktikë diskriminuese në baza racore, fetare, etnike, gjinore, ose aftësive speciale dhe aftësive të kufizuara të atletëve,

   - Të jeni vigjilent nga çdo forme të abuzimit ndaj atletëve tuaj, nga burime të tjera, atletët janë nën përkujdesin tuaj.

9. Të siguroheni se kontakti fizik me atletët është i përshtatshëm dhe i nevojshëm për zhvillim të aftësive të tyre.

   - Të siguroheni se metodat e asistimit janë në përputhje me parimet e themeluara të gjimnastikës,

   - Të siguroheni se asistimi përdoret vetëm për të siguruar dhe lehtësuar mësimin e një elementi gjimnastikorë,

   - Të siguroheni se një trajner i klubit tjetër nuk mund të vij dhe mbaj senaca stërvitore, apo të asistoj atletët edhe në prezence të trajnerit aktual.

   - Të siguroiheni se një trajner është e domosdoshme që gjatë stërvitjes ti ketë të vendosura dorezat në duar, sidomos gjatë asistimit të atletëve.

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+3834414500

IV. KODI I SJELLJES SË TRAJNERËVE

Duke u bazuar në këtë rregullore, duhet të arrihen kritere, në lidhje me sjelljen e trajnerëve, gjatë ndonjë aktiviteti të mbajtur ku mund të sanksionohen nga FGJK, si anëtarë të FGJK-së, klubi dhe në rolin tuaj si trajner i deleguar nga FGJK.

1. Duhet të jeni të vëmendshëm se të rinjët participtojnë për kënaqësi, dhe se fitorja është vetëm një pjesë e kënaqësisë.
2. Në asnjë mënyrë nuk lejohet tallja, dhe në asnjë mënyrë nuk lëjohet britma ndaj atletëve për ndonjë gabim eventual që ai/ajo mund të bëj, ose nëse nuk mund të vij ose dal i/e parë/a.
3. Jeni të arsyeshëm në kërkesat tuaja për kohën, energjinë dhe entuziazmin e atletëve.
4. Ushtroni në bazë të rregullave dhe kushteve të gjimnastikës që keni, dhe mësoni atletët që të bëjnë njëjtë.
5. Sigurohuni që koha e ushtrimeve, që ushtruesit kalojnë me ju të jetë një eksperiencë pozitive,
6. Të gjithë të rinjët respektojnë vëmendje dhe mundësi të njëjtë (shancë),
7. Shmangeni tejkalimin e ushtrimeve, sepse mesatarja e ushtrimeve kërkon dhe meriton kohë të barabartë,
8. Sigurohuni që pajisjet / veglat dhe infrastruktura, plotëson kushtet për ushtrime të sigurta, dhe se këto kushte janë në proporcion me moshën dhe me aftësin e atletëve,
9. Gjestet agresive nuk tolerohen.
10. Përgjigjuni të gjithë pjesëmarrësëve në mënyrë sensitive duke u bazuar në kërkësa apo pyetje, shmanguni veprimeve, përgjigjeve negative,
11. Identifikoni të drejtat e pjesëmarrësëve në klub që të konsultohen me ndonjë trajner tjetër ose këshilltar, kooperim të plotë me specialist (p.sh. shkencëtar sporti, doktor dhe fizioterapist).
12. Trajtoni të gjithë pjesëmarrësit në mënyrë të drejtë dhe fer, me kontekst të sportit dhe aktiviteteve të tyre, pa dallim të gjinisë, racës, vendit të origjinës, potencialit fizik, ngjyrës, orientimit seksual, religjionit, anës politike, statutit social ekonomik dhe kushteve tjera.
13. Të inkurajoni që pjesëmarrësit të kenë sjellje të lirë të lehtësoni pavarësinë dhe përgjegjësinë e pjesëmarrësëve, në vepra dhe veprime,
14. Që pjesëmarrësit të përfshihen në vendimet që u përket atyre,
15. Inkurajoni pjesëmarrësit të respektojnë njëri-tjetrin dhe të respektohen si individ pavarësisht nivelit të tyre pjesëmarrës,

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+3834414500

16. Sigurohuni që detyrat dhe/ose trajnimet janë të përshtatshme për moshën, përvojën, aftësinë, dhe kushtet fizike dhe psikologjike të pjesëmarrësëve.
17. Jeni të vetëdijshëm që ju si trajner keni ndikim mbi pjesëmarrësit tuaj gjatë seancave stërvitore, dhe shmanguni nga çdo intimitet seksual me pjesëmarrësit, që si rezultat mund të paraqitet.
18. Shmanguni situatave me pjesëmarrësit tuaj që mund të interpretohet si kompromis.
19. Në mënyrë aktive dekurajoj pjesëmarrësit, që mos të merren me përdorimin e drogës, alkoholit, duhanit, dhe substancave tjera të dëmshme dhe të paligjshme.
20. Mos shfrytëzoni ndikimin tuaj si trajner për nevoja personale, politike apo të biznesit, dhe nevojat personale ti shfrytëzoni si interes më të mirë për pjesëmarrëit tuaj,
21. Pranoni dhe respektoni rolin e zyrtarëve gjatë garave, duke u siguruar që garat janë mbajtur në mënyrë të drejtë dhe fer, sipas rregullave të vendosura.
22. Njihuni me rregullat, rregulloret dhe standardet, dhe inkurajoni garuesit që të veprojnë njejt.
23. Jeni të ndershëm dhe sigurohuni që kualifikimet të jenë interpretuar mirë.

Rregullorja është miratuar nga Bordi Ekzekutiv i FGJK-së, me datë 21/05/2026.

Kryetari i FGJK-së:
Shkumbin Maqastena

Sekretari i Përgjithshëm i FGJK-së
Amir Tahiraga

FGJK – KGF
Shtëpia e Sporteve, House of Sport, Rr – Str. "Agim Ramadani", 10000 Prishtinë, email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com, tel:+3834414500